



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 07**

**Datë: 19. 01. 2021. Ora: 14:00**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

**Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.**

**Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Artan Asllani, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.**

**SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.**

**ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.**

**Përkthyes: Argjina Misini**

**Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.**

---

**RENDI I DITËS**

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të KQZ-së nr. 60, 61/2020 si dhe 01, 02 dhe 03/2021.**

**3. Aktivitetet e SKQZ-së**

**4. Aktivitetet e ZRPPC-së**

-Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit mbi Caktimin e Lartësisë së Mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike për muajin janar dhe shkurt të vitit 2021

**5. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

## **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

- Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve dhe plotësimeve për propozimet e anëtarëve të KKZ-ve sipas komunave përkatëse,

-Shqyrtimi dhe miratimi i doracakut të procedurave të Votimit dhe Numërimit

### **6.Të ndryshme.**

---

#### **1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:**

**Valdete Daka:** Përshëndetje të gjithëve, e hapim mbledhjen e 7-të të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. A kemi vërejtje në rendin e ditës.

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të KQZ-së nr. 60, 61/2020 si dhe 01, 02 dhe 03/2021.

**Sami Kurteshi:** Faleminderit Kryesuese. Pajtohem me këtë rend dite, mendoj se duhet të futet një pikë tjetër e rendit të ditës ose shtesë duke marrur parasysh raportet e kaluar për përcjelljen e votave më post te mërgatës dhe në përgjithësi të votave edhe ngecjet e mundshme neper doganë. Unë propozoj që ne te diskutojmë për krijimin e një grupit nga te gjitha partitë politike , që edhe një bashkëpunim më doganën e Kosovës që i pranon dërgesat që vinë nga jashtë për Kosovën, ato ndahen dhe prandaj ato i ndan në posten e Kosovës, dhe pastaj posta e Kosovës me shpejtësi pa ndonjë ngecje, pa ndonjë problem të arrin në KQZ, duke e respektuar afatin që e ka përcaktuar Gjykata Kushtetuese dhe si përcaktohet më ligj, 24 orë para ditës së votimit ne mënyrë që posta ka mbërritur ne territorin e Kosovës që është e lejuar për KQZ, të mos ngec diku për arsye teknike, prandaj unë propozoj që të formohet një grup punues për të gjitha partive politike nga një përfaqësues edhe shoqërisë civile ata që janë të interesuar ta marrin dhe të e përcjellin këtë proces që ato mos te mbeten diku dhe të lejohen mbas 3-4 ditëve. Faleminderit.

**Sami Hamiti:** Nuk është problem më diskutuar, këtu kemi diskutime të ndryshme. Z. Kurteshi do të shiheni kur të mbërrimë të ajo pjesa e votimit jashtë vendit sepse KQZ-ja ka te nënshkruar posten, është e vërtet që interes i të gjitha partive dhe i neve këtu është që çdo votë që mbërrin deri në afatin e përcaktuar të jetë në ... postar. Unë e di që ne vitin 2019, ajo pjesë ka qenë e organizuar mirë dhe askujt prej partive politike nuk ju ka mohuar e drejta e vëzhgimit të ati procesit të ardhjes. Konsideroj që mënyra se si është bërë në 2019 kanë qenë ne kuptimin e ardhjes, ka qenë shumë mirë e organizuar sepse kanë qenë 2 elemente, njeri element nga airoporti i Prishtinës, shërbimi votues shkon dhe i merr me përcjellje të

policisë dhe i sjellë apo nga posta tranzitore në Fushë Kosovë po ashtu më përvjelje të policisë vinë në postar. Konsiderojë që formati i tillë është i sigurt sepse ajo marrëveshje ekziston, se asnjë parti politike nuk ju mohohet e drejta që të dërgon vëzhgues, unë e di që në vitin 2019 kanë dërguar vëzhgues edhe në procesin e bartjes së votave, është proces i cili është i menaxhueshem dhe mund të monitorohet nga partitë politike pa asnjë problem, pra nuk është problemi i ardhjes së votave deri në ditën 24, është problemi procesi ndoshta i ardhjes në natën ka më qenë pak ma sfidues, për ndryshe për ato që vijën deri në atë natë është sistem që shkon para dite dhe pas dite shërbimi votues së bashku me policin e i bien ne faunë postar.

**Valdete Daka:** Mirë, atëherë e diskutojmë, që të mos e konsumojmë diskutimin para se të fillojmë. Atëherë nëse pajtoheni më këtë rend dite, po e shoh se të gjithë po pajtohen. Vazhdojmë me piken e parë është shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të KQZ-ës, numër 60,61 të vitit 2020 dhe procesverbalet 01,02 dhe 03 të këtij viti. A ka dikush vërejtje? Apo i kemi ato vërejtjet e zakonshme në procesverbale, nëse nuk kemi vërejtje, unë i vendosi në votim, i dërgoni vërejtjet eventuale, ne parim i aprovojmë të gjitha. Kush është për? Faleminderit.

## **2.Aktivitetet e SKQZ-së**

**Burim Ahmetaj:** Faleminderit, Kryetare. Të nderuar anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sekretariati është duke punuar në bazë të planit operacional dhe aktualisht jemi në periudhat e shërbimit të votuesve jashtë vendit dhe periudhën e regjistrimit apo ndërrimit të qendrave të votimit, pra këto janë ato dy periudhat në të cilën sekretariati është duke punuar po ashtu e kemi si aktivitet tjetër dhe rikutujimin e stafit jo permanent ku jemi në proces e sipër, lidhur me periudhën e aplikimit për regjistrim dhe votim jashtë vendit ju njoftojmë që deri me sot pra deri me datën e ditës së sotme, pra raporti i referohet orës 12:00, ne sistem janë te futura gjithsej 14.307 aplikacione për regjistrim, prej tyre 13.138 aplikacione është bërë vlerësimi i zotësisë juridike, prej tyre të aprovuara janë 10.172 aplikacione. Në statusin momental të refuzimit janë 2426 aplikacione për regjistrim të cilat duhet të dërgohen dokumente mbështetëse pra më qellim të aprovimit, jemi në proces e sipër sigurisht që i kemi dërguar të gjitha informatat se cilat dokumente ju mungojnë më qellim që të plotësimi të tyre dhe për aprovim.

Nga raporti i ditës, tha ne vazhdim z. Ahmetaj, deri në orën 12:00 janë gjithsej rreth 68.000 email-a të pahapura, që do të thotë që sekretariati është në proces e sipër mirëpo ne mënyrë proceseve është duke procesuar, kjo nuk do të thotë që kemi stagnime në punë mirëpo kemi email-a të pa hapura, pra janë rreth 68.000. mirëpo është edhe një fakt i cili është i rëndësishëm të ceket sepse votuesit kanë dërguar ne të gjitha email-at njëkohësisht, pra mund të kemi dyfishime nga kjo shifër nga 68.000 mund te kenë dyfishime mirëpo kur të vazhdojmë me procesin e regjistrimit ne data bazë gjitha këto dyfishime do të largohen nga data baza dhe vetëm ata që i plotësojnë kriteret për zotësi juridike, pra të gjitha ato aplikacione do të aprovohen. Në raport i keni ne mënyrë tabelare të gjitha aplikacionet sipas shteteve dhe janë të listuara sipas shteteve dhe aplikacioneve.

Ndërsa, sa i përket periudhës së ndërrimit të qendrave të votimit gjithsej deri me tani kanë aplikuar 1300 votues për ti ndërruar qendrat e votimit ku prej tyre 1000 persona kanë aplikuar përmes aplikacionit dhe 300 votues kanë aplikuar për ndërrim të qendrave të votimit ne zyrat e komisioneve zgjedhore. Kjo periudhë ka filluar më 17 janar 2021, ndërsa sa i përket stafit jo permanent sekretariati ka përfunduar fazën e parë ku ka angazhuar stafin jo permanent të cilët kanë qenë të angazhuar ne zgjedhjet e fundit të viti 2019-2020 i keni te listuara dhe tash më është ne fazën e rikrutimit të pjesës tjetër të stafit në bazë konkurseve të shpallura nga sekretariati. Këto ishin aktivitetet nga sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe nëse keni pyetje mund të ju përgjigjem. Faleminderit shumë.

**Valdete Daka:** A ka dikush pyetje...?

**Alim Rama:** Faleminderit Burim për informatat e hollësishme. Siç e kemi diskutuar në mbledhjet me herët të këshillit e operacionit zgjedhor për shkaqe të volumit të madh te aplikacioneve, unë sygjeroj që sekretariati të merr të gjitha masat e nevojshme që këto aplikacione të trajtohen mirë , në kohë dhe në mënyrë të duhur. Vetëm po me shqetëson një fakt i terminologjisë që e përdorini këtu në raportin në pikën D, te cilën ne e marrim çdo ditë, në statusin momental të refuzimit. Realisht ata ose janë të pranimit ose të refuzimit. Sepse kam marrur shumë shqetësime nga bashkatdhetarët tanë që kanë marrur këtë email sepse nuk e kuptojnë dhe mendojnë që refuzohet automatikisht. Duhet të kemi masa shtesë që te dërgohet aplikacioni me kohë sepse ne kemi një datë e cila është shorti për parti politike dhe më datën 1 shkurt, dhe me datën 2 të gjitha aplikacionet duhet të përfundojnë.

**Valdete Daka:** Desha që të ju lutem qytetareve jashtë Kosovës që të mos e ngarkojnë email-in duke i dërguar nga 3 herë të njëjtat aplikime sepse si duket e kanë keqkuptuar qe ka me pasur ndonjë pengës

dhe tash për tu siguruar të dërgojnë email-in e njëjtë në 3 email-a tonë zyrtare dhe e bllokojnë pa nevojë email-in, të gjitha aplikacionet do të shqyrtohen, kështu që nuk ka nevojë me dërguar të njëjtën email disa here edhe vetëm që të shkaktojnë ngarkesa të panevojshme.

**Burim Ahmetaj:** Faleminderit Kryetare. Sekretariati është i obliguar të bej procesimin e të gjitha aplikacioneve, pavarësisht a janë dërguar një herë apo 3 herë, të gjitha këto aplikacione do të regjistrohen në data bazë do të verifikohen dhe të gjitha dyfishimet do të hiqen. Do të jemi të vëmendshëm të pika D, ku flet për statusin PENDING, ne sigurisht që komunikojmë më të gjithë ata votues të cilët nuk i kanë plotësuar dokumente, ju kërkojmë dokumente shtesë dhe kur të arrimë që brenda afatit të i marrim dokumentet shtesë atëherë do të mund të fitojnë dhe statusin e aprovuar. Pra, është fjala për ato që janë në pritje e sipër. Lidhur me atë që potencoi z. Rama sekretariati do të rris kapacitetin sidomos të pjesa e hapjes së email-ave, pra do të punojmë me një rritje të kapacitetit dhe nga nesër do të mundemi të punojmë më këtë shërbim në mënyrë që ta përforcojmë procesin e verifikimit, ne mënyrë që ti përfundojmë sa më shpejtë.

Konsiderojmë, tha Ahmetaj që, do e rrisim kapacitetin në aspektin e shërbimeve brenda votimit jashtë vendit, që i referohet më se shumti email-it dhe hapjen e email-eve dhe printimeve të dokumenteve për tu procesuar më tutje, pra thash edhe me herët nuk kemi stagnime më procesin, mirëpo kemi një fluks apo numër të madh të email-eve të cilët nuk kemi arritur ti hapim, sigurisht që do ti rrisim kapacitete do të ngritim edhe shërbime për këtë qëllim në mënyrë që të kemi materiale të mjaftueshme për të i verifikuar brenda afatit të paraparë më ligj. Kjo është e tera, faleminderit.

**Sami Kurteshi:** Rreth ekipit, telefonatat... Kam një pyetje ne lidhje me telefonatat. A kemi ndonjë informatë se si po shkon, cilat janë pengesat, cilat janë problemet? Kemi pasur dhe mesazhe të ndryshme një pjesë të atyre njerëzve që kanë marrur telefonata dhe ato telefonata kanë dalë si anonime, ka prej tyre më gjasë që kanë kundërshtuar me i jep të dhënat sepse është numri anonim. A keni të dhëna lidhur me këtë proces ju...?

**Burim Ahmetaj :** Faleminderit shumë kryetare. Sekretariati është i obliguar të bëjë procesimin e të gjitha aplikacioneve pavarësisht, a janë dërguar një herë apo tri here? Po të gjitha këto aplikacione do të regjistrohen në database. Do të verifikohen dhe të gjitha duplikimet pastaj do të heket. Do të jeni të vëmendshëm tek pika D ku flet për statusin pending. Na sigurishtë që komunikojmë me të gjithë ata votues të cilët nuk i kanë plotësuar dokumentet. Ju kërkojmë dokumente shtesë dhe në momentin që

mund ti arrijmë brenda afatit ti marrim dokumentet shtesë atëherë do të mund ta fitojnë edhe statusin e aprovuar, por është fjala për ato që janë në pritje e sipër. Lidhur me atë që e potencojë Zotri Rama, sekretariati do ta rrisë kapacitetet sidomos tek pjesa e hapjes së email, pra do të punojë me një rritje të kapaciteteve. Nga nesër do të mund të fillojmë me këtë shërbim në mënyrë që ta përforcojmë procesin e verifikimit në mënyrë që ti kemi sa ma shpejt.

Pra, konsiderojmë se do ta rrisim kapacitetin në aspektin e shërbimeve brenda votimit jashtë vendit, që i referohet ma shumë e-mail dhe hapjes së e-mailave edhe printimit të dokumenteve për tu procesuar ma tutje. Pra thash edhe ma heret nuk kemi stagnim në proces, mirpo kemi fluks apo numer të madh të imellave të cilat nuk kemi arritur ti hapim, sigurisht që do ti rrisim kapacitetet, do të ngritim edhe shërbimin për këtë qëllim në mënyrë që të kemi materiale të mjaftueshme për ti verifikuar brenda afatit të paraparë me ligj.

**Sami Kurteshi:** Kam një pyetje në lidhje me telefonatat. A ka ndonjë informatë? Si po shkon? Cilat janë pengesat? Cilat janë problemet? Kemi pas sigurisht mesazhe të ndryshme për një pjesë të atyre njerëzve që kanë marr telefonata, edhe ato telefonata kanë dalë si anonime. Ka prej tyre me gjasë që kanë kundërshtu me dhanë të dhëna sepse është numri anonim. A keni të dhana në lidhje me këtë proces? Si është duke shiku? Cilat janë problemet kryesore? A ka probleme fare apo jo edhe sa ka mrii numri?

**Burim Ahmetaj:** Faleminderit. Sekretariati, është duke punuar në këtë aspekt me këtë shërbim në mënyrë progresive. Deri më dje janë telefonuar, apo janë marr konfirmime dikun rreth 8 mijë votues që konsiderojmë që nuk kemi stagnim në këtë aspekt. Kemi pas problem teknik, në raste të caktme ka mund edhe të mos ju shfaqet numri, mirpo besoj që ky element teknik që posta veq e ka rregulluar. Ndërsa sa i përket thirrjes së votuesve sigurisht që nuk do të ngelet vetëm me një thirrje por do të tentohet prapë në thirrjen e dytë, prapë në thirrjen e tretë, varësisht edhe prej procesimit pra, deri sa ta marrim konfirmimin e fundit nuk do të shterrojmi thirrjet ndaj kategorisë së verifikimit. Pra nuk do të kemi nevojë të angazhojmë resurse shtesë në këtë aspekt sepse në mënyrë progresive po arrijmë sa processohen në futjen e të dhënave në shërbimin votues. Po ashtu ato menjherë plasohen apo dergohen tek qendra e thirrjeve, pra nuk kemi ngecje në këtë aspekt. Mirpo është me rendësi të ceket se votuesit do ti thrrasin pavarisht tentimit të parë, pavarisht të dytë. Do të vazhdojmë në mënyrë progresive ti thërrasim.

**Valdete Daka :** Po urdhno Sami.

**Sami Hamiti:** Ndoshta në rastin tjetër, se pyetja e Z.Kurteshit ishte shumë me vend . çështjen e komunikimit dhe vërtetimit të personave të cilët kanë apliku për regjistrim. Unë u mundova me timen pak i kqyra statistikën. Me herën e parë janë lajmruar dikun, sa është 78% dmth është një përgjigje e mire. Por herën tjetër. Ne bisedum në KOZ. Ka raste të cilat duhet të tregohen që janë telefonuar personat që kanë qar aplikimet dhe nuk janë ata. Keni rastet të cilat njerëzit d.m.th., dikush ka apliku për ta dhe ata në telefonat kanë thanë që ne nuk kemi apliku edhe në ato raste duhet të jenë të evenindetuara dhe ti paraqesim këtu para KQZ-së. Ka raste kur lajmërohet, telefoni i tij apo i saj, por ai tregon që nuk ka apliku për votim, por mund ta shohim edhe atë regjistër se a e kemi të saktë edhe unë e pash ata që e the në mënyrë progresive ne do ta kemi ma problem qasjen e hapjes së imellave. Sepse qasja që u bojke problem tek komunikimi dhe telefonatave po del që është ma e lehtë. Kështu që në mbledhjen tjetër këtij raporti të ja shtoni edhe këtë pjesën që e kërkova d.m.th edhe sa janë komunikues? Me sa njerëz është komunikuar? Sa vet janë lajmru? Sa është ajo përqindje? Sa vetë prej tyre kanë thanë që nuk janë ata që kanë apiku e si pjesën tjetër te kemi në këtë raport.

**Alim Rama:** Një informatë që e mora unë dikur rreth 8 mijë sa keni bërë thirrje , 78% janë konfirmuar dhe disa dhjetra thirrje kanë qenë .... Aty diku apo është numri tjetër ose është diku tjetër?

**Valdete Daka:** Ndoshta nuk është mire meqenëse i kemi këtu edhe mediat të dalim me shifra të pakonfirmuara. Le ti konfirmojnë shifrat të sakta edhe te dalim me raport se na tek e fundit na mundemi me mbajte edhe një takim edhe ma vonë edhe nesër në mëngjes, por nuk është çështje urgjente por le ti kemi shifrat e sakta që mos të krijohen. Mandej menjëherë po fillojnë keqkuptimet nëpër media, nëpër portale, nëpër facebook. Në qofte se nuk kemi diçka tjetër. Atëherë, të fillojmë me aktivitetet e ZRPP-së.

**Burim Ahmetaj:** Aktualisht shifra për momentin nuk kemi, por sigurisht në mbledhjen e radhës do të ju japin shifrat e sakta. Numrin e saktë sa kanë konfirmuar? Sa janë në pritje sepse neve na duhet prapë të kthehemi për ti thirrur prapë dhe sa është me atë elementin që nuk janë ata votues. Sigurisht që në mbledhjen e radhës do të ju sjellim raportin.

**Valdete Daka:** Atëherë vazhdojmë me aktivitetet e ZRPP-së.

### **3.Aktivitetet e ZRPPC-së**

Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit mbi Caktimin e Lartësisë së Mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike për muajin janar dhe shkurt të vitit 2021:

**Yll Beleshkaj:** E nderuar kryetare. Të nderuar anëtar. Faleminderit shumë për fjalën e dhënë. Shumë shkurt vetëm te ju informojë. Edhe pse keni pranuar raportin jemi në proces. Në përfundim të procesit të shqyrtimit të aplikacioneve për certifikim qoftë ato për parti politike po ashtu edhe për kandidatët e tyre e deri tani kemi dërguar shkresat nëpër emisione relevante për praninë të informative konfirmuese. Të gjithë ata të cilët me ligj kërkohet të na kthejnë përgjigje. Lu kemi dërgu shkresa, nga disa kemi pranuar, ndërsa nga disa të tjerë po presim që deri nesër në mesditë pranojmë konfirmimet përfunditare e pastaj pas tyre do të dalin në rekomandim si zyrë. Përveç tyre, jemi në shqyrtim të dy aplikacioneve të cilat kanë qenë deri vonë të pa kompletume, tash janë në përfundim e sipër të dy subjekteve politike. Si përmbledhje ashtu siç e dini ju tani kemi 28 aplikacione për certifikim për subjekte politike si total tani kemi 1081 kandidatë. Nga ta janë 362 gra apo 33.5% dhe 719 burra apo 66.5% d.m.th këtu nga aspekti gjinor nuk ka ndonjë përmirësim të madh nga hera e kalimeve në qoftë se mundem me kujt si përmirësim, afërsisht numrat janë si të njëjtë. Nga komuniteti ashkali tani kemi 3 subjekte politike që kanë aplikuar me 119 kandidatë.

Nga komuniteti boshnjak tani kemi 5 subjekte politike me 145 kandidatë. Nga komuniteti egjiptian tani kemi 2 subjekte politike me 79 kandidatë. Nga komuniteti goran po ashtu tani kemi 2 subjekte me 32 kandidatë. Nga komuniteti romë kemi 4 subjekte politike janë 2 iniciativa dhe 2 parti politike dhe që kanë si total 64 kandidatë. Nga komuniteti serb 3 subjekte politike nga to 1 parti politike dhe 2 iniciativa me 28 kandidatë total. Nga komuniteti shqiptar tani kemi 7 parti politike që kanë aplikuar me 580 kandidatë dhe nga komuniteti turk kemi 38 kandidatë që vijnë nga 2 parti politike. Pra radhitja është në mënyrë alfabetike, po ashtu si fillon shkronja e parë e komunitetit. Po ashtu siç e dini edhe ju janë 21 parti politike që kanë aplikuar, kanë treguar interes kësaj radhe për pjesëmarrje, 5 iniciativa qytetare dhe 2 koalicione zgjedhore. Pra jemi në përfundim të shqyrtimit të aplikacioneve dhe se shumë shpejtë do të dalin rekomandimet para jush.

Përveç kësaj një detyrë e rëndësishme e zyrës është edhe shqyrtimi i aspektit financiar të partive politike. është koha tash që KQZ-ja të vendos edhe për ndarjen e fondit përcaktimin e aftësisë së fondeve për mbështetjen e partive politike për muajin Janar shkurt të këtij viti. Arsyeja pse nuk kemi dal me rekomandim për gjithë vitin të gjithë e dimë që jemi në zgjedhje dhe shpërndarja e fondit do të bëhet kështu në baza mujore sepse formula e ndarjes së fondit e dimë që është e bazuar në ulëset e kuvendit të



Kosovës. E dimë që kuvendi I Kosovës është në proces zgjedhor. Do të thotë fondi total për këta dy muaj është 700.000 euro. I cili është I ndarë më shuma ashtu si I keni para jush. Duke u bazuar në ulëset që I kan fitu në zgjedhjet paraprake këto subjekte politike. Numrat janë të konfirmime nga divizioni I financave në mënyrë që të jemi më të saktë. I rekomandoj KZZ që të aprovohet rekomandimi jonë dhe të nxjerr aktvendimin, përcaktimin e lartësisë së mjeteve nga fondi ashtu siç, i keni para jush. Në qofte se keni pyetje si për piken e parë ashtu edhe për të dytën. Jam shume i lumtur të përgjigjem.

**Valdete Daka:** Faleminderit Yll. Po udhno Sami.

**Sami Kurteshi:** Faleminderit Z.Kryesuse. Ju thatë që I keni dërgu ato letrat institucioneve përkatëse bazuar me gjasë edhe në aktgjykimin së gjykatë kushtetuese që e ka kërku bashkëpunim ndërinstytucional. Nëse, nuk e kam kuptu, nëse nuk e kam dëgjuar gabim zëdhënësin e KQZ-së me gjasë, ka thanë se do ti dërgohet edhe AKI-së. A, i keni dërgu letër edhe AKI-së? Edhe qka kërkohet nga AKI-a? Meqenëse AKI-ja, është institucioni që mbledh informata por nuk është intitucion ekzekutiv.

**Yll Buleshkaj:** Pytja shumë e mire dhe e drejtë. Të përshtatshmëria juridike e kandidatëve pjesëtarët e partisë e kanë të ndaluar të jenë kandidatë për deputet. Kjo, është arsyeja pse i kemi shkru AKI-së në mënyrë që të na kthen përgjigje, mos ndonjëri nga këta kandidatë është edhe pjesëtarë i AKI-së. Njëjtë sic, është edhe me Doganën e Kosovës sepse kanë ndaluar njëjtë siç është rasti edhe me prokurorin e shtetit sepse prokurorët e kanë ndaluar njëjtë siç është rasti edhe me anëtarët e PZAP-it. Dhe gjuhësorit në Kosovë sepse e kanë të gjithë të ndaluar të jenë kandidatë duke përfshirë këtu edhe policinë e Kosovës. Pra kjo është arsyeja pse ju ka shkrujt të gjithë këtyre institucioneve.

**Valdete Daka:** Nëse s’kemi diçka tjetër. Unë e kisha qit në votim vendimin mbi caktimin e lartësisë së mjeteve nga fondi për mbështetjen e subjekteve politike për muajin Janar dhe Shkurt të vitit 2021, pas shpjegimit të drejtorit të zyrës...

**Yll Buleshkaj:** Faleminderit shumë. çka vlen të shtohet është sepse vendimi parasheh edhe pikën numër 4 e cila parasheh që shpenzimet që janë parapa për veprimtarin e secilit deputet. Do të mbulohen vetëm ato që kanë ndodhur deri në shpalljen e zgjedhjes deri me të 7 që i bjen, me 6 janar. Ndërsa pas shpenzimit që kanë mujtë me bo deputet pas datës nga 7 janari e tutje nuk do të mbulohen nga fondi sepse e dimë që Kuvendi I Kosovës funksionon vetëm me kryesi.

**Valdete Daka:** Nëse nuk kemi pyetje tjetër në lidhje me këtë çështje. Kush është për caktimin e lartësisë së mjeteve? Miratohet...Faleminderit. Vendimi tjetër do të bëhet menjëherë sekretarisë që ta implementoj. Vazhdojmë me raportin e këshillave tjera. Këshilli për operacione zgjedhore.

#### **4.Raport i Këshillave të KQZ-së:**

##### **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

1.Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve dhe plotësimeve për propozimet e anëtarëve të KKZ-ve sipas komunave përkatëse:

**Alim Rama:** Në këshill për operacione zgjedhore sot kemi trajtuar plotësimin edhe ndryshimin te disa anëtarëve të KKZ-së. Lista e anëtarëve të rinj që i plotësojnë ato vende të zbrazëta është para jush. Edhe në mënyrë unanime këshilli për operacione zgjedhore rekomandon që të aprovohet në KQZ.

**Valdete Daka:** Kush është për zëvendësimin e anëtarëve të KKZ-ve, sipas listës që e keni për plotësimin dhe zëvendësimin. Miratohet...Faleminderit. Vazhdojmë me pikën tjetër miratimi i doracakut të proceduarave.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i doracakut të procedurave të Votimit dhe Numërimit:

**Alim Rama:** Faleminderit kryesuse. Vetëm një sqarim i vogël doracaku është i njëjtë sikurse për të gjitha zgjedhjet e kaluara me një ndryshim që nuk ceket viti i zgjedhjeve që ja mundëson sekretariatit që ti ripërdor këto doracak në çiftë se nuk ndërrohen edhe për zgjedhjet e radhës.

**Valdete Daka:** Mirë atëherë kush është për? Miratohet... Mirë në të ndryshme patëm një çështje për të cilën dikush dha shpjegime. Urdhëro Burim.

##### **5.Tw ndryshme**

**Burim Ahmetaj:** Mirë atëherë kryetare, zgjedhjet e fundit për Kuvendin e Kosovës 2009 pakon me fletëvotime i kemi pranuar në qendrën tranzitore, postare në Kosovë. Pra aty është vendi ku do të merren të gjitha këto pakot me fletëvotime pra që vijnë përmes linjave ajrore në aeroport të gjitha këto mblidhen në këtë qendër. Kjo është procedura që i marrim zakonisht në secilin proces zgjedhor.

**Sami Hamiti:** Është që ekipet që kanë shkuar për ti marr votat në postën tranzitore kanë qenë me përcjellje të Policisë për më mirë është Besniku si proces pasi e din më mirë si shkon.

**Eshref Vishaj:** Tek kontaktet me faun postal a janë ditore apo brenda ditës apo vizitohet më shpesh brenda ditës mos ka ndonjë dërgesë.

**Besnik Buzhala:** Sa t`ju shpjegoj juve dhe publikut qendra tranzitore postare është pika grumbulluese e të gjitha kodeve postare që vijnë në Kosovë edhe ato dërgesa postare dërgohen në bazë të institucioneve ose, në bazë të adresave të marrësit. Në këtë pikë në 2019 është praktikuar për herë të par që KQZ-ja ka shkuar dhe i ka marr në qendrën tranzitore postare këto pako me fletëvotime. Ajo çka është e rëndësishme ta dimë që këto pako me fletëvotime janë marr gjithmonë me përcjellje të Policisë edhe janë ftuar vëzhguesit e akredituar të subjekteve politike, tash në shumë raste vëzhguesit nuk shpreh interesim të vijnë, po flas për zgjedhjet e vitit 2019 kjo ka qenë praktika që ne e kemi përdorur në 2019. Kemi shkuar po ashtu edhe në famën postare sepse ka posta që nuk vijnë në postën tranzitore por shkojnë direkt në faun postar, ato që janë posta të shpejta që quhen, për shembull kemi pasur raste prej Kanadasë e prej Amerikës që vijnë direkt në famën postare e kemi kontrolluar.

Të njëjtën rrugë, tha z. Bushala, kur kemi shkuar në të njëjtën dit kemi shkuar dhe kemi marr në postën numër 6 që e kemi famën 351, të njëjtën rrugë e kemi përshkruar dhe kemi marr ato zarfe që ne i quajmë zarfe të supozuara me fletëvotime sepse nuk e dimë a janë fletëvotime deri në ditën e zgjedhjeve edhe kur fillojmë ti hapim dhe ti vlerësojmë ato. Kjo është praktika që e kemi përdorur në 2019 dhe që ka qenë praktik shumë e mirë, edhe mendojë që si praktik e tillë duhet të përdoret prapë edhe në këto zgjedhje për shkak që t`ju shmangemi vonesave. Ajo çka bëjmë ne në qendrën tranzitore postare e eliminojmë punën që mundet ta bëjë posta numër 6, aty bëhet një regjistrim në qendrën tranzitore postare atë regjistrim që bëhet ne e shmangim duke e bërë një regjistrim tjetër në postën numër 6 do të thotë

regjistrimet që bëhen në qendrën tranzitore postare ne ato i marrim me përcjellje të policisë i sjellim në zyrat e shërbimit të votuesve ku ajo zyre po ashtu sigurohet përgjatë 24 orëve nga policia e Kosovës.

**Valdete Daka:** Me rëndësi është që të gjitha subjektet politike njoftohen për datën e shkuarjes dhe mundet ti dërgojnë vëzhguesit e tyre.

**Besnik Buzhala:** Kur kemi shkuar ne në qendrën tranzitore postare i kemi njoftuar edhe vëzhguesit e akredituar të subjekteve politike. Nga praktika po them se ka pasur fare pak interesim për të ardhur në qendrën tranzitore postare me e mbikëqyr procesin e pranimin të pakove me fletëvotime po kjo është praktika të cilën e kemi ndjekur në 2019, që sipas mendimit tim është praktik e mirë.

**Eshref Vishaj:** Kryetare unë e kam një kërkesë për zyrtarët e administratës. Është mirë që fau postal të mbyllet me datën dhe orën e caktuar me ligj, të respektohet ligji dy dit para ditës së zgjedhjeve dhe mos të ndodh që këto dërgesa të pranohen dhe pas datës së përcaktuar me ligj.

**Besnik Buzhala:** Për sa i përket faut ose postes numër 6. Në të gjitha proceset e tjera zgjedhore ajo post mbyllet në 7:00 ose 8:00 të mbrëmjes ne gjithmonë e verifikojmë, edhe para mbylljes së postës numër 6 ne gjithmonë shkojmë e kontrollojmë a ka pako me fletëvotime brenda. Nëse deri momentin kur mbyllet ka ndonjë pako ne e tërheqim kthehem dhe raportojmë mbylljen e procesit të marrjes së pakove të supozuara me fletëvotime është data me plan operacional. Për këto zgjedhje është data 12 shkurt e cila është data e fundit kur pakot me fletëvotime duhet të pranohen në pakon postare.

**Eshref Vishaj:** Unë këtë po e them sepse në zgjedhjet e fundit nuk ka ndodhur kështu kemi pasur raste që edhe pas kësaj date janë pranuar.

**Besnik Buzhala:** Arsyeja pse ne i kemi marrë dokumentet pas kësaj datës së paraparë është që ato dokumente janë për KQZ-n, ato zarfe para së gjithash përmbajnë të dhëna personale edhe pse janë pasa afatit janë zarfe të cilat janë pronë e KQZ-n. Duhet të tërhiqen që në kohën kur asgjësohen këto materiale duhet të asgjësohen. Ajo që ka ndodhur në vitin 2019 me ankesat që janë parashtruar dhe vendimet që janë marrë neve na kanë obliguar si sekretariat për ta zbatuar vendimin.

**Sami Kurteshi:** Faleminderit që po diskutohet për këtë çështje, faleminderit edhe për informatat e dhëna. Ligji dhe rregullorja dhe akt gjykimi i Gjykatës Kushtetuese mbaron 24 orë para ditës së zgjedhjeve ky është afati i caktuar. Mua po më intereson vetëm momenti prej doganës deri në post ai proces a është i vëzhguar edhe a ka vonesa në atë drejtim. Meqenëse këtë pjesën prej qendrës tranzitore e kuptuam drejt dhe faleminderit për informatën, mua më intereson vetëm kjo pjesë. Faleminderit.

**Besnik Buzhala:** Mundem t`ju informoj edhe për këtë pjesë. Qendra tranzitore postare që gjendet në Fushë Kosovë e ka një zyre që i ndan me doganën e Kosovës. Tash ato që vijnë në doganën e Kosovës regjistrohen edhe menjëherë kalohen në hapësirën ku zarfet kategorizohen në bazë të adresës së marrësit do të thotë e ndajnë një objekt të përbashkët. Dogana e Kosovës është në anën e majtë menjëherë është në anën e djathtë është zyra ku bëhet klasifikimi i zarfeve. Brenda qendrës tranzitore postare gjendet edhe dogana e Kosovës ky është procesi që ka ndodhur në vitin 2019 ku kam qenë edhe unë prezent e kam kryer atë punë në zgjedhjet e kaluara për Kuvendin e Kosovës të 6 tetorit 2019.

**Sami Hamiti:** Unë desha më shumë të mos ndodh ajo që ka ndodhur në vitin 2019 të vijnë pakot me zarfe poste jo nisëse me ardhë as të Dheut të Bardh as Jarinjës as Merdarit. Çështja në procedurën që vendosim me ligj të shkojnë në fund në herën e kaluar kemi pasur një milion telashe me atë punë është mirë që është një akt gjykim, e kemi një akt gjykim nga Gjykata Kushtetuese meqë e rregullon atë punë. Prandaj as mos u merrni me atë pjesë është sugjerim sepse e keni akt gjykimin.

**Alim Rama:** Unë desha ti bazohem një raporti të Gremenit i cili pikërisht e shprehi aty shqetësimet e tyre gjatë analizës që jo të gjitha pakot kanë pasur vule datare. Kështu që unë kisha kërkuar prej KQZ-s në bashkëpunim me postë që të sigurohen të gjitha zarfet, të gjitha pakot që vijnë që të vulosen që të dihet koha e pranimit se raporti i Gremenit ka treguar shumë pa rregullsi në kuadër të postës jo që është problemi i KQZ-s por neve si organizatë që administrojmë procesin zgjedhor duan që pakot të vijnë të vulosura. Një që një kërkesë një shkresë nga ana e KQZ-s në post të kenë një kujdes më të shtuar dhe që të gjitha pakot që mbërrijnë para 24 orëve gjatë procesit zgjedhor me pas planin operacional, e përmendi Besniku është gabim që është e premtë. 24 orë siç e potencon ligji dhe vendimi i gjykatës është e shtune 24 orë para procesit zgjedhor, i gjithë qëllimi i këtij është që rezultatet me post mos të jenë të influencuara nga zgjedhja. Ligji thotë se është e shtune, procesi zgjedhore mbaron të dielën në ora 7:00, rrjedhimisht i bie të shtunën në ora 7:00 ky proces.

**Arianit Elshani:** E pata këtë çështje që e ngriti z. Hamiti lidhur që të kemi kujdes pra dita e zgjedhjes po afrohet ku dhe dita e fundit që vijnë nga jashtë e veçmas këto nga mërgata. Keni parasysh respektoni ligjet edhe ashtu siç udhëzohemi nuk ka nevojë as veturat e KQZ-s të shkojnë nëpër pika kufitare po as të vijnë. Edhe tjetra as nuk ka nevojë të shkelen as udhëzimet as ligjet lidhur me postat që vijnë nga jashtë pra fahu postal, posta tranzitore, Dogana e Kosovës janë pikat që ne i referohemi në njëfarë forme. Pra të kemi kujdes veçmas për ato vota po edhe tjerat që mos të shkelen dhe rregullat që i kemi të përcaktuara që na udhëzojnë që të pranohen ato vota...